



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 12628 Prot

Lezhë, më 07 / 07 /2022

VENDIM

Nr. 80, Datë 06 . 07 .2022

**Për një shtesë e ndryshim në Buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe përdorim të fondit të emergjencës për “Rehabilitimin e murit mbajtës në rrugën e Spitalit Rajonal Lezhë”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”; të VKM nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile nr. 1007/1, datë 17. 06.2022 “Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2022”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

**Vendosi :**

1. Miratimin e një shtese në buxhetin e bashkisë për vitin 2022, si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2022 në shumën 18,551,675 lekë, fond i cili është akorduar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

1/2-Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor si më poshtë:

- Gr.17, Prog.03280, Kap.01, Art.604 për shumën 18,551,675 lekë, fond i cili do të përdoret për punimet në “Rehabilitimin e murit mbajtës në rrugën e Spitalit Rajonal Lezhë”.

2. Miratimin e përdorimit të fondit të emergjencës në shumën 4,648,608 lekë.

Për këtë të kryhen këto veprime:

- Pakësohet: Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art.602 për shumën 4,648,608 lekë.
- Shtohet: Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art.231 për shumën 4,648,608 lekë, fond i cili do të përdoret për:

a- Punime në “Rehabilitimin e murit mbajtës në rrugën e Spitalit Rajonal Lezhë” në shumën 4,028,608 lekë.

b- Supervizim punimesh në shumën 500,000 lekë.

c- Kolaudim punimesh në shumën 120,000 lekë.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI  
ERNEST RAKAJ**





Prot 12628/  
Dt 12.7.22.

WB.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 483/5 Prot.

Lezhë , më 08.07 2022

L ë n d a : Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b, ligjin nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjin nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile” , konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 80, datë 06.07.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe përdorim të fondit të emergjencës për Rehabilitimin e murit mbajtës në rrugën e Spitalit Rajonal Lezhë”.

**P R E F E K T I**

**Gjergj PRENDI**

